



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI “ISMAIL QEMALI” VLORË
DREJTORIA E SIGURIMIT TË BRENDSHËM TË CILËSISË DHE ZHVILLIMIT INSTITUCIONAL
SEKTORI I PROJEKTEVE DHE MARRËDHËNIEVE ME JASHTË



Universitatea
Transilvania
din Braşov

Thirrje për mobilitet stafi për trajnim në kuadër të Programit Erasmus+ për komponentin KA1 në Universitetin Transilvania të Brasov në Rumani

Universiteti i Vlorës “Ismail Qemali”, në bashkëpunim me Universitetin e Transilvanisë të Brasov në Rumani (Transilvania University of Brasov) në kuadër të Programit Erasmus+ për komponentin KA1, fton stafin ndihmës akademik dhe administrativ të punësuar me kontratë me afat të pacaktuar në UV, të aplikojnë për të përfituar një bursë për trajnim për një periudhë prej 5+2 ditësh në Universitetin e Transilvanisë të Brasov në Rumani.

Mobiliteti në këtë institucionin pritet të përmbushet brenda muajit **Maj 2019** të vitit akademik **2018-2019**.

Shpenzimet do të mbulojnë nga skema Erasmus +, komponenti KA1 për mobilitet stafi. Ato parashikojnë shumën prej **275 Euro** për udhëtimin vajtje-ardhje si dhe dietën ditore prej **140 Euro/ditë**.

Numri i bursave për trajnim: 1 (një)

Kriteret për aplikantët:

- të jetë staf efektiv i Universitetit “Ismail Qemali” Vlorë;

Kriteret e përzgjedhjes: (në varësi të universitetit pritës)

- Eksperienca në punë
- Prioritet i jepet stafit që nuk ka patur më parë eksperiencë mobilitetit.
- Njohja e gjuhës së huaj sipas nivelit të përcaktuar në marrëveshjen ndër-institucionale.
- Kriteret e tjera shtesë mund të përfshijnë:
 - Motivimi
 - Vjetërsia në punë
 - Barazia gjinore (aty ku është e mundur të përzgjidhen kandidatë të barabartë në numër për nga gjinia).
 -

Dokumentet e nevojshme për aplikim:

- Formular aplikimi
- Kopje të pasaportës



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
DREJTORIA E SIGURIMIT TË BRENDSHËM TË CILËSISË DHE ZHVILLIMIT INSTITUCIONAL
SEKTORI I PROJEKTEVE DHE MARRËDHËNIEVE ME JASHTË

- Vërtetim punësimi
- CV
- Certifikata e gjuhës së huaj që vërteton njohjen e gjuhës angleze
- Letër argumentuese (rreth 300 fjalë) në gjuhën angleze lidhur me qëllimin dhe përfitimin institucional të mobilitetit, bazuar në prioritetet e nënvizuara sipas udhëzimeve të Komisionit Evropian për këtë skemë.

(<https://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/organisations#tab-1-1>).

Dokumentet e aplikimit duhet të dorëzohen pranë Sektorit të Projekteve dhe Marrëdhënieve me Jashtë brenda datës **16/11/2018** ora **16:00**.

Kandidatët fitues do të njoftohen prej Sektorit të Projekteve dhe Marrëdhënieve me Jashtë brenda datës **23/11/2018** ora **16:00** në adresën e tyre të e-mailit.

Për përzgjedhjen e stafit ndihmës akademik dhe administrativ ngrihet një komision i cili vlerëson stafin.

Procesi i brendshëm i përzgjedhjes nuk garanton që mobiliteti do të kryhet. Përzgjedhja duhet të konfirmohet nga institucioni pritës përmes një letre pranimi/ftese.

Për të dhëna të mëtejshme rreth skemës së mobilitetit dhe mënyrës së aplikimit mund të kontaktoni me Ina Binaj: international@univlora.edu.la, Specialiste e Marrëdhënieve me Jashtë ose me Sektorin e Projekteve dhe Marrëdhënieve me Jashtë, pranë Rektoratit, Kati i I.

SUKSESE!